



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:290958  
Datë: 09.01.2025  
Numri i dokumentit: 06691907

CA.nr.12344/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Qerim Ademaj kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.N nga P....., të cilën e përfaqëson D.K avokat nga P....., kundër të paditurës Komuna e Pejës-Drejtoria për Shëndetësi, për kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2019, 2020 dhe 2021, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4485/23, të datës 29.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.01.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses V.N nga P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4485/23, të datës 29.09.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4485/23, të datës 29.09.2024, ka vendosur si në vijim: *“I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses V.N, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Pejës, që paditëses t’ia paguaj në emër të pagës së trembëdhjetë (13) në vlerën e pagës bazë për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në lartësinë e pagës bazë prej 518.40 euro, e në shumën e përgjithshëm prej 1,555.20 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e arritjes për pagesë, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarrimit të detyrueshëm. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale. ”*

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditëses brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën e paditëses si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e paditëses është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 21.12.2023 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në shumën e përgjithshme prej 1.555 €, kundër të paditurës, me detaje të tjera të përshkuara si në padi.

Gjykata e shkallës së parë jashtë seancës ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit ankimor duke u bazuar në nenin 399 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4485/23 të datës 29.09.2024 me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadiën e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se gëzon shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadiës, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara. Në bazë të vërtetimit me numër të protokollit ....., të datës 26.04.2022, të lëshuar nga Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare në Pejë gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja V.N ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pacaktuar nga data 01.11.1999 e tutje, nga shkresat e lëndës gjejmë se paditësja gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 518.40 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadiës, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se “Punëmarrësi mund të

kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. (Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023).

Tutje ka theksuar se në bazë të raportit buxhetor për vitin 2020, për kodin buxhetor 74100-Shëndetësia-Kujdesi Primar Shëndetësor, ku gjykata në bazë të përmbajtjes së këtij raporti vërtetoi faktin se për këtë kategori për vitin 2020 në emër të kodit 111-Paga dhe mëditje ishin të ndara 3,192.311.20 euro, të cilat përgjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të vitit 2020 ishin të realizuara 3,192.311.20 euro, pra si rrjedhojë e lartcekurave kuptohet se e paditura/punëdhënësi i ka realizuar/shpenzuar të gjitha mjetet e destinuar për paga dhe mëditje. Përmes këtij kodi buxhetor , gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, në fakt ka qenë në deficit buxhetor. E njëjta gjendje paraqitet edhe në vitin pasues, konkretisht në vitin 2021, ku në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për këtë vit, buxheti fillestar ka qenë në shumë prej 2,906,404.66 euro, kurse buxheti i shpenzuar në shumë prej 2,906,404.66 euro, pra në përlllogaritje të thjeshtë vërtetohet fakti se e paditura/punëdhënësi nuk ka pasur suficit buxhetor.

Lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se kërkesa është e përfshirë edhe në parashkrim për vitet 2018 dhe 2019, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, e po ashtu pati parasysh edhe nenin 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”. Paditësja padinë e ka paraqitur me datë 21.12.2023, e në qoftë se kërkesa për kompensimin e pagës së 13-të, do të kishte themelësi atëherë e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2019, e që nga fundi i vitit 2019 e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite e gjysmë, pra pasi që padia është paraqitur me datë 21.12.2023, konstatohet se kanë kaluar më shumë se 3 vite e gjysmë.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 450 dhe 463.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëseve se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me nenin 17 paragraf 2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018 përcaktohet se: *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.”*. Andaj, në rastin konkret me të drejtë i është refuzuar paditëses V.N, kompensimi në emër të pagës së trembëdhjetë (13) në vlerën e pagës bazë për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në lartësinë e pagës bazë prej 518.40 euro, e në shumën e përgjithshëm prej 1,555.20 euro, pasi që sipas kodit buxhetor 74100-Shëndetësia-Kujdesi Primar Shëndetësor, ku gjykata në bazë të përmbajtjes së këtij raporti vërtetoi faktin se për këtë kategori për vitin 2020 në emër të kodit 111-Paga dhe mëditje ishin të ndara 3,192.311.20 euro, të cilat përgjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të vitit 2020 ishin të realizuara 3,192.311.20 euro, pra si rrjedhojë e lartcekurave kuptohet se e paditura/punëdhënësi i ka realizuar/shpenzuar të gjitha mjetet e destinuara për paga dhe mëditje. Përmes këtij kodi buxhetor , gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, ka qenë në deficit buxhetor andaj gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, në fakt ka qenë në deficit buxhetor, vërtetohet se e paditura, nuk ka pasur mundësi buxhetore për pagesën e pagës së 13-të. Këtë fakt e mbështet edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (mendimi juridik për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale

lidhur me kërkesat e pagës së 13-të, të punëtorëve të shëndetësisë e dt.09.10.2023, faqja 2, pasuesi i fundit), ku përcaktohet se: Nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë.

Lidhur me pretendimin e paditësit se në bazë të Raportit të Auditimit për Pasqyra Financiare të Komunës së Pejës për vitet 2019, 2020, 2021 ka pasur tepricë buxhetore/suficit, Gjykata e Apelit një pretendim të tillë e refuzon të pathemeltë për të vendosur ndryshe, pasi që në raportin e paraqitur nga paditësja janë përlllogaritur burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas të gjitha kategorive ekonomike në emër të Komunës së Pejës, andaj në rast se ka pasur suficit/tepricë në një kategori/linjë, ndërsa në tjetrën ka pasur deficit, atëherë bartja e mjeteve nga një kategori në tjetrën nuk është i lejuar, sipas Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, nenit 13 të këtij Ligji, par. 6 përcaktohet ndër të tjera se: *“shpenzimi i parave publike nga kategoria e për mallra dhe shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punëtorëve, qoftë në formën e shtesave”*. Përmes kësaj kuptohet se edhe sikur e paditura të kishte pas suficit buxhetor në linjë tjetër buxhetore, e ka të ndaluar që të bëjë kompensimin për kategorinë e kërkuar nga pala paditëse. Sipas nenit 2 të po të njëjtij ligj, *këto dispozita ligjore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre që bien në fushëveprimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021*. Po ashtu në interpretim edhe të dispozitave të Ligjit Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet 2019 dhe 2020, rezulton të kemi ndalesën e njëjtë për bartjen e mjeteve nga një kategori në tjetrën. Edhe në këto ligje materiale që kanë qenë në fuqi secili në kohën kur paditësja ka kërkuar kompensimin e pagave të 13-ta, kompensimet nga kategoritë apo linjat e tjera buxhetore si mallra dhe shërbime, kanë qenë të ndaluara. Në këtë kuptim, pala e paditur përmes raporteve të bashkangjitura me përgjigje në padi, i ka provuar pretendimet e veta, se në fakt në periudhat në të cilat paditësja ka kërkuar kompensimin e pagës së 13-të, nuk kanë pasur mundësi buxhetore. Ndërkaq, referuar kompensimit të pagës së 13-të, për vitin 2020, kemi të bëjmë me pamundësinë buxhetore të Komunës së Pejës, e meqenëse vendosja për këtë çështje i atribuohet nenit 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*, e që kjo dispozitë ka alternativën “mund”, duke e paraparë varësisht nga mundësitë buxhetore të punëdhënësit, e që pamundësinë buxhetore e paditura e ka argumentuar me provat bashkëngjitur me përgjigje në padi, konsideron se padia e paditëses duhet refuzuar mbi bazën e argumenteve të ofruara nga e paditura.

Gjykata e Apelit lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses ka konstatuar se kërkesa është e përfshirë edhe në parashkrim për vitet 2018 dhe 2019, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ku paditësja padinë e ka paraqitur me datë 21.12.2023, e në qoftë se kërkesa për kompensimin e pagës së 13-të, do të kishte themelësi atëherë e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2019, e që nga fundi i vitit 2019 e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite e gjysmë.

Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për çka edhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit 450 dhe 463.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
CA.nr.12344/2024, me datë 09.01.2025

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari  
Qerim Ademaj d.v.